

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6997
E shtunë, 16 shtator 2023
Çmimi 0.40 €

ShBA-ja dhe Gjermania, të
zhgënjyera për mungesën
e përparimit në dialog **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

USAID-I DHE KOSOVA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE MBËSHTETËSE
FINANCIARE NË VLERË RRETH 35 MILIONË DOLLARË **FAQE 3**

RIKONFIRMOHET PARTNERITETI I PALËKUNDUR, SHBA-ja E NDIHMON FINANCIARISHT KOSOVËN



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së USAID-it, Kerry Monaghan Hogler, kanë nënshkruar një marrëveshje në vlerë 34 727

milione dollarë. Me këtë rast, Osmani ka thënë se kjo marrëveshje kontribuon në avancimin e raporteve Kosovë - ShBA. Ndërsa ambasadori amerikan Jeffrey

Hovenier, duke e vlerësuar lart këtë marrëveshje, ka thënë se që nga viti 1999 ShBA-ja ka investuar më shumë se 2 miliardë dollarë në Kosovë

AKTUALE



**KONJUFCA: NUK PRANOJMË
BOSNJËZIMIN E KOSOVËS** **F. 5**

**BE-ja MOHON SE PROPOZIMI I
KURTIT ISHTE I VETMI NË TAVOLINË** **F. 7**

**HARADINAJ KËRKON DORËHEQJEN
E KURTIT** **F. 4**

**KOMANDANTI I FSK-SË E NDERON
ME MEDALJE MAJORIN GJERMAN** **F. 7**

EKONOMI



**QYTETARËT E KOSOVËS PËR NJË
VIT SHPENZUAN MBI 4 MILIONË
EURO PËR VIZAT SHENGEN** **F. 8**

**TERMOCENTRALI AUSTRIAK TESTOI
KOMBINIMIN E GAZIT NATYROR
DHE HIDROJENIT PËR PRODHIMIN
E ENERGJISË ELEKTRIKE** **F. 8**

SPORT



**PËRPLASEN FFK-JA DHE FC
PRISHTINA** **F. 10**

VETERANËT E UÇK-SË GJUAJNË TELFONA NË DREJTIM TË OBJEKTIT TË EULEX-it

FAQE 4



CILAT JANË DALLIMET DHE ÇKA I BASHKON UDB-në DHE GJYKATËN SPECIALE



Shkuan:
Behxhet
Sh. SHALA
- BAJGORA **FAQE 5**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Mbi 700 milionë njerëz nuk e dinë nëse do të ushqehen më

NJU-JORK, 15 SHTATOR - Një krizë globale e urisë i ka lënë më shumë se 700 milionë persona me dilemat nëse apo kur do të mund të ushqehen sërish, ka thënë shefja e Agjencisë e Kombeve të Bashkuara për Ushqim, Cindy McCain. Ajo ka thënë në një takim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së se për shkak të mungesës së fondeve, agjencia është detyruar t'i ndalë shumë ndihma për miliona persona dhe se

“shkurtime të tjera do të ndodhin shpejt”. “Ne jemi duke jetuar tani me një seri të krizave afatgjata, të cilat do të vazhdojnë ta rritin nevojën për ndihma humanitare. Ky është realiteti i ri i komunitetit humanitar – normalja e re – dhe do ta vazhdojmë të përballemi me situata të tilla edhe në vitet që po vijnë”. Shefja e kësaj agjencie – e veja e senatorit të ndjerë amerikan John McCain – ka thënë se vlerësohet që gati

47 milionë njerëz në mbi 50 shtete janë vetëm një hap larg urisë dhe 45 milionë fëmijë nën moshën pesëvjeçare besohet se po përballen me kequshqim. Në gjetjet e tjera është përmendur se 783 milionë njerëz në 79 shtete të botës flenë të uritur çdo natë. Ndër faktorët kryesorë që kanë çuar në këtë situatë besohet se janë kombinimi i konflikteve, kriza ekonomike, kriza ekstreme dhe rritja e çmimeve.



Ukraina raporton për suksese në fushëbetejë

KIEV, 15 SHTATOR - Ukraina ka raportuar për fitore të shumta në kundëroffensivën ndaj forcave ruse, ndërkohë që presidenti i vendit, Volodymyr Zelensky, përgatitet për një takim me presidentin e ShBA-së, Joe Biden. Takimi i planifikuar për javën e ardhshme mund të rezultojë i rëndësishëm për sigurimin e mbështetjes së mëtejshme ndërkombëtare për Kievin në luftën kundër Rusisë.

Zyrtarët amerikanë kanë konfirmuar se Bideni do të takohet me Zelenskyn në margjinat e takimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në ShBA javën e ardhshme. Liderët e ShBA-së dhe Ukrainës priten të flasin në sesionin e 78 të mbledhjes së OKB-së më 19 shtator.

Zelensky pritet ta përdorë takimin e tij me liderët amerikanë dhe botërorë për të siguruar mbështetje dhe për të kërkuar armë dhe municione të avancuara, ndërsa pushtimi i Ukrainës nga Rusia po i afrohet muajit të 20.

“Washington Post” ka raportuar se vizita e Zelenskyt është pjesë e një shtytjeje të përbashkët “për ta detyruar Kongresin amerikan të sigurojë 24 miliardë dollarë ndihmë shtesë



për Ukrainën”. Kjo vizitë pason samitin e presidentit rus Vladimir Putin, këtë javë me liderin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, në Rusi, në atë që zyrtarët perëndimorë besojnë se mund të jetë një përpjekje e Moskës për të shkëmbyer teknologji të avancuar me municione për ta ndihmuar luftën e saj në Ukrainë. Putini dhe Kimi thuhet se po planifikojnë të takohen sërish në Korenë e Veriut, me ftesë të liderit korean-verior.

“CNN” ka cituar burime republikane të kenë thënë se Zelensky do të takohet edhe me ligjvënësit dhe udhëheqësit e tjerë amerikanë.

Takimi i javës së ardhshme Biden - Zelensky do të ishte takimi i parë i tyre që nga korriku kur u takuan në margjinat e një samiti të NATO-s në Lituani.

Zelensky ka vizituar për herë të fundit Shtetet e Bashkuara të Amerikës në dhjetor, në udhëtimin e tij të parë jashtë

vendit që nga fillimi i pushtimit nga Rusia në shkurt të vitit 2022. Raportet sugjerojnë se është shtuar presioni nga ShBA-ja dhe aleatët e tjerë mbi Ukrainën për të demonstruar sukses në kundëroffensivën që nisi në qershor.

Zelensky në fjalimin e tij ka thënë se forcat ukrainase kishin arritur një “triumf” më herët gjatë ditës duke “shkatërruar” mbrojtjen ajrore ruse në Krimenë e pushtuar. Një burim i inteligjencës

ukrainase i ka thënë “Reuters”-it se sistemi i mbrojtjes ajrore pranë Yevpatoriya u shkatërrua në atë që tha se ishte një sulm me dronë dhe raketa gjatë natës, i kryer nga Shërbimi i Sigurisë dhe marina e Ukrainës. Imazhet satelitore duket se konfirmojnë dëme të rënda në një zonë ku ishin pozicionuar armët ruse në Yevpatoriya. Shkatërrimi i raportuar i sistemit të mbrojtjes ajrore erdhi një ditë pasi Ukraina dëmtoi rëndë dy anije luftarake ruse në Krimë. Në fillim të 15 shtatorit, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës tha se trupat ukrainase kishin rimarrë qytetin Andriyivka në Donjeck, rreth 10 kilometra në jugperëndim të Bahmutit, “duke i shkaktuar armikut humbje të konsiderueshme në fuqi punëtore dhe pajisje”. Një ditë më parë zëvendësministria e Mbrojtjes, Hanna Malyar, kishte njoftuar çlirimin e Andriyivkës përpara se ta tërhiqte deklaratën e saj dhe të thoshte se luftimet e ashpra atje po vazhdonin dhe situata ishte “shumë e vështirë dhe e paqëndrueshme”. Ushtria e Ukrainës tha, gjithashtu, se kishte “sukses të pjesshëm” në zonën pranë Klishchivkas.

Rekord i 100-vjeçarëve në Japoni

TOKIO, 15 SHTATOR - Numri i 100-vjeçarëve në Japoni e ka kaluar shifrën 92 000 për herë të parë, duke shënuar rekord për të 52-in vit me radhë, është thënë në një raport të Qeverisë së Japonisë të premten. Numri i personave mbi 100 vjeç është rritur për 1 613 në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 92 139, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Tokio. Sipas sondazheve

të fundit, rreth 88 për qind e të gjithë 100-vjeçarëve janë gra. Jetëgjatësia e grave në Japoni është rreth 87 vjet, ndërsa për burrat 81 vjet. Japonia është përballur me rritje të shpejtë të numrit të 100-vjeçarëve, prej kur qeveria ka nisur t'i mbledhë të dhënat më 1963 - atëbotë kanë qenë vetëm rreth 153 persona në atë moshë. Japonia është duke u përballur me ndryshime të

mëdha demografike, pas disa dekadave me regjistrim të plakjes së popullsisë dhe uljes së natalitetit. Popullsia e Japonisë është duke u zvogëluar me shpejtësi të madhe. Vitin e kaluar numri i japonezëve është ulur për 801 000, duke arritur në 122.4 milionë, njëherësh ulja më e madhe në krahasim me periudhën kur kanë nisur të mblidhen të dhënat.



Komandanti i FSK-së e nderon me medalje majorin gjerman

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Bashkim Jashari, ka pritur në takim lamtumirës këshilltarin bilateral për logjistikë rreshter-major Stephan Stieber nga Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë. Në një njoftim për medie të FSK-së është thënë se rreshter-major Stephan Stieber disa vjet ka punuar ngushtë me FSK-në.

Sipas këtij njoftimi, gjeneralletenant Jashari, duke respektuar punën dhe angazhimin e tij gjatë periudhës 2017-2023, e ka dekoruar me medaljen "Shërbim Vetëmohues". "Gjatë shërbimit të tij për disa vite në Kosovë si këshilltar për Logjistikë Stieber, ka punuar ngushtë me FSK-në, duke ndihmuar në ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve logjistike në Forcën e Sigurisë së Kosovës ai ka treguar

përkushtim, angazhim dhe mbështetje të vazhdueshme për Forcën e Sigurisë së Kosovës duke kontribuar në forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit në mes FSK-së dhe ushtrisë gjermane. Gjeneral Jashari duke respektuar punën dhe angazhimin e tij gjatë periudhës 2017-2023 ka dekoruar me medaljen "Shërbim Vetëmohues", ka njoftuar FSK-ja.



USAID-I DHE KOSOVA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE MBËSHTETËSE FINANCIARE NË VLERË RRETH 35 MILIONË DOLLARË

Rikonfirmohet partneriteti i palëkundur, ShBA-ja e ndihmon financiarisht Kosovën

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së USAID-it, Kerry Monaghan Hogler, kanë nënshkruar një marrëveshje në vlerë 34 727 milionë dollarë. Me këtë rast, Osmani ka thënë se kjo marrëveshje kontribuon në avancimin e raporteve Kosovë - ShBA. Ndërsa ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier, duke e vlerësuar lart këtë marrëveshje, ka thënë se që nga viti 1999 ShBA-ja ka investuar më shumë se 2 miliardë dollarë në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe ushtruesja e detyrës e drejtoreshës së USAID-it, Kerry Monaghan Hogler, kanë nënshkruar të premtën një marrëveshje në vlerë prej 34 727 milionë dollarësh. Kjo marrëveshje është nënshkruar në bazë të amendamentit numër 5 të marrëveshjes së grantit. Në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ka marrë pjesë edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Osmani dhe Hovenieri kanë mbajtur një konferencë për medie. Me këtë rast, Osmani ka thënë se kjo marrëveshje kontribuon në avancimin e raporteve Kosovë - ShBA. Ajo ka thënë se një nga objektivat parësore të kësaj marrëveshjeje është sigurimi i shërbimeve më të mira për të gjithë qytetarët e Kosovës nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve institucionale. "Në këtë mënyrë do të fuqizohet administrata publike, do të eliminohet burokracia dhe do të promovohet transparenca. Duke



llogaritur llogaridhënien dhe efikasitetin brenda institucioneve publike, kjo marrëveshje do të kontribuojë në reduktimin e vazhdueshëm të korrupsionit dhe rritjen e efikasitetit ndaj nevojave të qytetarëve tanë", ka thënë Osmani.

Më tutje, Osmani ka shprehur mirënjohje të thellë për, siç ka thënë ajo, vendosmërinë e palëkundur të ShBA-së, që të jenë krah Kosovës në përpjekjet kah zhvillimi dhe nevojat e qytetarëve. "Në përpjekjet tona për të garantuar një të ardhme më të begatë për qytetarët tanë, ShBA-ja nuk ka ofruar vetëm mbështetje, por një partneritet të vërtetë, një partneritet të ndërtuar në besim të ndërsjellë

dhe të fuqizuar nga vlerat e përbashkëta. Andaj në emër të të gjithë qytetarëve të Kosovës ua shpreh mirënjohjen tonë të thellë për vendosmërinë e palëkundur që të jeni krah nesh në përpjekjet tona për të ndërtuar një Kosovë të orientuar kah zhvillimi dhe nevojat e qytetarëve tanë", ka thënë Osmani.

Ndërsa ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se me këtë marrëveshje është duke u rikonfirmuar partneriteti i qëndrueshëm dhe afatgjatë i ShBA-së me popullin e Kosovës. "Mendoj se është e duhur ta konfirmojmë sërish partneritetin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të ShBA-së me popullin e Kosovës. Ky fond

shtesë do t'i mbështesë qëllimet strategjike të ShBA-së për Kosovën, përfshirë përpjekjet për avancimin e integritetit të Kosovës në institucionet evropiane, përpjekjen për promovimin e rritjes dhe përparimin ekonomik, si dhe përpjekjen për përforcimin e qeverisjes së mirë", ka thënë Hovenieri.

Ai ka theksuar se të gjitha programet e USAID-it në Kosovë kanë për qëllim t'i sigurojnë të gjithë qytetarët të kenë qasje efektive në shërbimet që i ofrojnë institucionet e tyre. "Që nga viti 1999 ShBA-ja ka investuar më shumë se 2 miliardë dollarë në Kosovë për t'i çuar përpara qëllimet tona të përbashkëta", ka thënë Hovenieri.



Tahiri: Integrimi në BE, NATO dhe KE, rrugë njëkahëshe për Kosovën

PARIS, 15 SHTATOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, është duke qëndruar në Paris të Francës, aty ku Beatrice Fresko Rolfo nga Monako është zgjedhur raportuese e Komisionit të Këshillit të Evropës për Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim. Tahiri ka potencuar se me këtë emërtim është përmblyllur

caktimi i raportuesve nga Këshilli i Evropës. "Komiteti i Këshillit të Evropës për Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim e votoi, znj. Beatrice Fresko Rolfo nga Monako si raportuese të këtij komisioni. Me këtë emërtim u përmbyll caktimi i raportuesve nga Këshilli i Evropës. Më herët është emëruar raportuesja nga

AS/Pol për raportin, znj. Theodora Bakoyannis, nga Greqia, dhe raportuesja AS/Jur për opinion, znj. Azadeh Rojhan, nga Suedia. Gjatë qëndrimit në Paris theksova se Kosova ka një Kushtetutë shumë të avancuar për të drejtat e njeriut, sikurse përkushtimi politik në Kuvendin e Republikës së Kosovës për t'u

anëtarësuar në Këshill i tejkalon agjendat e brendshme politike", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Ai ka potencuar se në diskutime me deputetë të vendeve anëtare të BE-së ka theksuar se rruga drejt integritetit euroatlantik në NATO, BE e në institucione si Këshilli i Evropës është rrugë njëkahëshe për Kosovën.





Veteranët e UÇK-së gjuajnë telefona në drejtim të objektit të EULEX-it

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK-së) ka protestuar të premten para ndërtesës së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), duke e kritikuar këtë institucion dhe Gjykatën Speciale të Kosovës për shqetësim të familjeve të veteranëve.

Gjykata Speciale është duke hetuar krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera ndaj pakicave etnike dhe rivalëve politikë nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Gjykata e ka selinë në Hagë, por funksionon sipas ligjeve të Kosovës.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka kërkuar reagim të autoriteteve të Kosovës, duke pretenduar se Gjykata Speciale dhe EULEX-i po u shfaqën pa paralajmërim veteranëve. "Jeni dëshmitarë që Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë dhe EULEX-i janë duke i shqetësuar familjet e bashkëluftëtarëve tanë dhe familjet e dëshmorëve, duke dërguar pa paralajmërim njerëz

të panjohur e me kapela në kokë për, gjoja, intervistë, duke i bastisur e duke ua konfiskuar telefonat personalë", ka thënë Klinaku.

Ai e ka bërë këtë deklaram disa

ditë pasi ish-figura të UÇK-së, përfshirë Rrustem Mustafën dhe Nait Hasanin, kanë njoftuar se hetuesit e Gjykatës Speciale u janë paraqitur në shtëpitë e tyre me kërkesë për kontroll të

telefonit. "Personeli nga Gjykata Speciale është sjell me respekt. Në zyrë të EULEX-it më është sekuestruar telefoni im dhe posa është bërë ky kontroll, pa asnjë interesim shtesë nga ana e tyre, ka

përfunduar biseda", ka njoftuar Mustafa në "Facebook".

Gjykata Speciale nuk është deklaruar rreth rasteve. Si shenjë proteste ndaj veprimeve të EULEX-it, protestuesit i kanë hedhur disa telefona drejt ndërtesës së misionit evropian. "Duke pasur parasysh se Policia e Kosovës është reaguesja e parë, kërkojmë që shteti të merret seriozisht dhe të mos lejojë që persona civilë, pa policinë, të na hyjnë në shtëpi, përndryshe do të ketë reagime të vazhdueshme qytetare", ka thënë Klinaku.

Gjykata Speciale i ka dënua dy pjesëtarë të OVLUÇK-së, Nasim Haradinajn dhe Hysni Gucatin, në maj të vitit 2022, për pengim të administrimit të drejtësisë. Dënimi fillestar për secilin ka qenë 4 vjet e gjysmë burgim, ndërsa pas ankesës në Apel koha u është zvogëluar në 4 vjet e tre muaj burgim. Aktualisht në Hagë është duke u zhvilluar gjyqi ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, dhe ish-deputetit Rexhep Selimi. Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.



Haradinaj kërkon dorëheqjen e Kurtit

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, pas dështimit të takimit të së enjtes në Bruksel, ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti të japë dorëheqje.

"Këtë veprim duhet ta bëjë edhe nëse ai mendon se është në rrugë të drejtë. Ai obligohet ta pyesë popullin se çka mendon për veprimet e tij. Në demokraci zgjedhjet janë përgjigja më e mirë", ka

shkruar Haradinaj në "Facebook". Më tutje, ai ka thënë se në rast të mungesës së reflektimit të Kurtit, përgjegjësia mbetet te liderët e tjerë politikë, që të bashkohen dhe të vepronë

urgjentisht për ta dërguar vendin në zgjedhje, duke e shkarkuar Kurtin përmes mocionit. "Është koha ta pyesim popullin se si të dalim nga kjo gjendje e rrezikshme", ka shkruar Haradinaj.



Cilat janë dallimet dhe çka i bashkon UDB-në dhe Gjykatën Speciale



Shkuan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA, i ikur në një lokacion ilegal nga frika nga EULESH -i

Gjërat që i bashkojnë: UDB-a dhe udbashët në fillim të luftës çlirimtare në Kosovë e kidnapuan Nait Hasanin duke e keqtrajtuar brutalisht deri se edhe jetën ia rrezikuan. Po të mos ishte KMDLNj-ja që e alarmoi rastin dhe po mos ta dërgonte Destan Rukiqin, avokat dhe anëtar i Këshillit në polici, fati i Nait Hasanit do të merrte drejtim tjetër, mbase nuk do të ishte i gjallë. Intervenimi i KMDLNj-së përmes avokatit Rukiqi për Naitin thauja i kushtoi me jetë Destan Rukiqit, u rrahë mizorisht nga

milicia dhe udbashët serbë duke luftuar me vdekjen disa ditë. Vetëm Zoti e shpëtoi. Para disa ditëve në një pritë të udbashëve të EULEX-it u kidnapua Nait Hasani dhe u dërgua në bazën e EULEX -it në Fushë Kosovë. Edhe UDB-ja kishte shumë baza. Naiti nuk u keqtrajtua por iu morë telefoni dhe që nga ai çast vëzhgohet dhe mbahet peng i lirë. Jakup Krasniqi ishte arrestuar dhe keqtrajtuar mizorisht nga UDB-ë dhe udbashët serbë dhe shqiptarë. Ishte dënuar me burg afatgjatë dhe të rëndë por jo më shumë se 20 vjet. Pas çlirimimit, si bartës i lartë i posteve institucionale, ministër dhe kryetar Kuvendi si dhe u.d. i presidentit ishte bastisur brutalisht nga udbashët e EULEX -it dhe alienët e Speciales për t'u transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Trajta mashkullore e Danica Marinkoviqit, kryeprokurori Smith e ka kërcënuar me burgim të përjetshëm, më mizor se gjykatat serbe.

Hashim Thaçi ishte dënuar në mungesë me 15 vjet burgim për aktivitet politik dhe kombëtar nga gjykatësi Zdravkoviq kurse kryeprokurori Smith e kërcënon me burgim të përjetshëm. Cilësimet e aktakuzës nga binjakët siamezë (Zdravkoviq/ Smith) janë të njëjta, dallimi është në nuanca. Edhe Nasim Haradinaj ishte burgosur dhe dënuar nga udbashët e Serbisë, i njëjti "fat" e përcolli nga udbashët e Speciales. Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Hysni Gucati dhe Pjetër Shala ishin të pakapshëm për udbashët e Serbisë, por u arrestuan nga këta të Speciales. Sipas të njëjtit model. Salih Mustafa kaloi shumë më lehtë nga gjykatat e Serbisë se nga Gjykata Speciale raciste e Hagës. UDB-ja ushtronte dhunë fizike dhe psikike ndaj shqiptarëve të arrestuar, të gjithë shqiptarë, veprimtarë kombëtarë dhe politikë. Kishte raste kur i vriste ose vdisnin për shkak të torturave. Gjykata Speciale nuk ushtron dhunë fizike por ushtron terror psikologjik, zbaton shantazhin në

mënyrë flagrante dhe të palejueshme, korrupton dhe kërcënon dëshmitarët sikur që përndjek të gjithë ata që e kundërshtojnë. Për të ardhur deri te "e vërteta" sipas standardeve të tyre, pamëshirshëm e dhunon dhe e vret të vërtetën. Në mënyrë të paskrupullt ndërhyjnë në familje duke e dhunuar privatësinë. Skema e rekrutimit të dëshmitarëve nuk dallon aspak, atëherë shqiptarë të ndershëm, tash shqiptarë të ndershëm, sikur atëherë. "Elitat" politike të atëhershme bashkëpunonin me gjykatat serbe, "elitat" aktuale kosovare bashkëpunojnë me Gjykatën Speciale. Në vend të mbledhjes së fakteve, Gjykata Speciale po mbledhë telefona duke e rrezikuar privatësinë. Këta telefona pastaj i përdorin për shantazhim ndaj dëshmitarëve dhe kërcënim ndaj kundërshtarëve. Gjykatat serbe ishin të huaja dhe armiqësore për shqiptarët, të tilla po bëhen edhe "gjykatat e Kosovës" në Hagë. Me dënimet e shqiptuara deri tani

dhe me kërcënim për dënimet e ardhshme, gjykatat serbe po dalin të jenë humane krahasuar me Gjykatën Speciale Raciste të Hagës. Gjykata Speciale, nëse fillon të keqtrajtojë fizikisht shqiptarët e dyshuar apo të arrestuar, mund të barazohet me gjykatat serbe. Nëse vret të burgosurit apo të dyshuarit, fiton epërsi ndaj gjykatave serbe. Gjykata Speciale e ka bërë Kosovën "lamë thiu", bënë çka të donë, në çdo kohë dhe kur t'i çohet. Sikur që ky vend të ishte jetim apo pa zot shtëpie. Edhe është pa zot shtëpie.

Jemi vonuar për dekorata: Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, e ka dekoruar udbashin Dimiq për kontributin e tij për rekrutimin e dëshmitarëve shqiptarë dhe të tjerë në proceset e kurdisura kundër ushtarëve të UÇK-së dhe udhëheqësve të shtetit të Kosovës në Hagë. Presidentja e Kosovës ende nuk e ka dekoruar "shqiptari", bashkëpunëtor i Dimiqit për të njëjtin kontribut. Marre i qoftë!

Konjufca: Nuk pranojmë bosnjëzimin e Kosovës

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke komentuar takimin në Bruksel midis kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) ka qasje të pabalancuar. Ai e ka kritikuar BE-në se kërkesat e saj ndaj Kosovës korrespondojnë me kërkesat e Serbisë. "Jo të gjitha marrëveshjet mund të pranohen. Qasja e BE-së është e pabalancuar sepse të gjitha kërkesat që parashtrohen në drejtim të Kosovës korrespondojnë me ato që po na i kërkon Serbia. Siç është dorëheqja pa kurrfarë procedure e kryetarëve të komunave, zhvleftësimi i procesit demokratik dhe i ligjshmërisë të institucioneve tona. Të gjitha këto janë kërkesa të Serbisë e që, fatkeqsisht, BE-ja po na i kërkon. Ne nuk mund ta shkelim shtetin tonë", ka thënë ai, duke shtuar se nuk e pranojnë themelimin e një asociacionin që është kundërkushtetues. "Është e



papranueshme për Kosovën. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse në shtator palët kanë pasur një përpjekje shtesë për t'ia dhënë një zgjidhje ngërçit që është krijuar përmes asaj për ta zgjeruar përmbajtjen e marrëveshjes dhe për të bërë gjithëpërfshirëse e për

t'ia rritur substancën politike. Përmes marrëveshjes së Ohrit është përpjekur që të rregullohet marrëdhënia e jashtme Kosovë - Serbi. Këtë e rregullon neni 2 i Marrëveshjes së Ohrit, ku thotë se shtetet do të funksionojnë si dy shtete sovraane sipas principeve të

kartës së Kombeve të Bashkuara. Në këtë kuadër të transformimit të marrëdhënieve, kur ato bëhen miqësore, Kosova e themelon Asociacionin. Përndryshe Kosova nuk ka obligim t'ia japë asociacionin Serbisë dhe ne të mbetemi të panjohur nga Serbia e

të luftohemi. Kjo do të ishte katastrofike dhe me pasoja të mëdha", ka thënë ai.

Në këtë kontekst, kryeparlamentari Konjufca ka thënë se nuk pranojnë bosnjëzimin e Kosovës. "Nuk do të lodhemi kurrë që edhe më tutje të argumentojmë me Bashkësinë Ndërkombëtare se ky është një pozicionim që Kosova nuk heq dorë. Po të hiqte dorë mund të çojmë në bosnjëzimin e Kosovës. Populli e ka votuar LV-në për ta ndaluar e bosnjëzimit të Kosovës. Asociacioni është pranuar prej qeverive të kaluara. Nuk mund ta kthejmë në pikën zero. Ne e kuptojmë që Kosova nuk ka kapacitete ta kthejë në zero atë proces. Por, që ta realizojmë obligimin tonë, a mund të na garantoni që Serbia nuk do ta përdorë këtë mekanizëm për ta minuar shtetësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare nuk po jep garanci. Bashkësia ndërkombëtare duhet të japë garanci të fuqishme, jo vetëm fjalë goje", ka thënë Konjufca.

Lajçaku: Kosova dhe Serbia kanë mosbesim të madh ndaj njëra-tjetrës

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Miroslav Lajçak, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, ka komentuar takimin në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit Aleksandër Vuçiq. Në një prononcim për agjencinë e lajmeve të

Slovakisë, "TASR", Lajçaku ka vlerësuar se të dyja palët kanë mosbesim ndaj njëra-tjetrës. "Megjithatë, zbatimi i vërtetë i marrëveshjes nuk ka filluar në gjashtë muaj. Të dyja palët kanë një shkallë të madhe mosbesimi ndaj njëra-tjetrës. Ata thonë ma jep atë që meritoj dhe pastaj

do të bëj atë që është e nevojshme", ka thënë Lajçaku. Më tutje, ai ka thënë se për shkak të kësaj qasjeje BE-ja ka paraqitur një propozim prej shtatë pikash që i lejon të dyja palët ta vazhdojnë paralelisht zbatimin e marrëveshjeve. "Jam i bindur

se marrëveshja e Ohrit është dokumenti më i mirë. Të dyja palët e kanë pranuar dhe do të ishte turp të shkonte huq. Në atë rast presim më shumë konflikte, përshkallëzim të tensionit dhe më shumë dhunë në veri të Kosovës", është shprehur Lajçaku.



Certifikohen 185 kandidatë që kaluan provimin e Jurisprudencës

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, të premtën ka marrë pjesë në ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave për kandidatet të cilët kanë kaluar provimin e jurisprudencës. Në këtë ceremoni kanë diplomuar 185 kandidatë.

Me këtë rast, ministria Haxhiu ka thënë se provimi për këta kandidatë ka qenë një proces merit, transparent dhe profesional. Ajo u ka bërë juristëve që punën ta bëjnë me nder dhe profesionalizëm duke u bazuar në Kushtetutën

e Kosovës e ligjet në fuqi. "Ka qenë një proces merit, transparent dhe profesional. Ngjarjet e tilla që shtojnë kuadrot për t'u bërë pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovës pasurojnë vendin tonë. Jemi në fazën e reformimit duke filluar nga legjislacioni, infrastruktura dhe përgatitja e kuadrove të reja. Të gjitha këto reforma mund të jenë të suksesshme kur kemi kuadro të kualifikuara. Duke respektuar parimet më të larta profesionale dhe etike. Unë sot

ju lutem, kudo që jeni, kudo që do të orientoheni, si gjyqtar, prokuror, avokat apo profesion të tjera, ta bëni punën vetëm me nder dhe profesionalizëm, vetëm duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës, legjislacionet në fuqi, konventat ndërkombëtare, sepse për njerëz të tillë ka nevojë Republika e Kosovës. Sot është moment i gëzueshëm jo vetëm për ju, por edhe se shtetit po i shtohen edhe më shumë profesionistë", ka thënë Haxhiu.



Kurti: Jemi të interesuar që sa më shumë të rinj të studiojnë në STEM



PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka mirëpritur në takim rrjetin "STEM Ambassadors", të rinj e të reja nga Kosova dhe diaspora, të dalluar në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë). Ky rrjet, i cili do të lansojë edhe platformën këtë muaj me anë të financave nga Ambasada e Kanadasë, përfshin ambasadorë që do të ndihmojnë vullnetarisht për çdo aktivitet, që do të organizohet në të ardhmen

qoftë nga institucionet e ndryshme apo nga organizatat që zbatojnë projekte të këtyre fushave.

Sipas njoftimit, kryeministri Kurti, duke vlerësuar objektivat e të rinjve, informoi se janë dhënë 3 978 bursa për studime në fushat STEM brenda dhe jashtë vendit, duke dyfishuar edhe buxhetin për to. Kësisoj qeveria ka ofruar mbi 1 300 bursa për fushat STEM në vitin akademik 2021-2022 vetëm për vajza dhe mbi 1 600 bursa për fushat STEM në vitin 2022-2023 për vajza dhe djem.

"Pjesëmarrja e vajzave në studime në fushat STEM në Universitetin e Prishtinës është në masën 50 për qind dhe këtu asnjë vend nuk mund të krahasohet me ne sepse në vendet e Bashkimit Evropian është 17 për qind, relativisht i bie 1/3 e kësaj që kemi ne", ka thënë Kurti duke theksuar se janë të interesuar që sa më shumë vajza të studiojnë në STEM.

Me këtë rast, këtë vit është mbajtur konferenca e parë kombëtare për gra dhe vajza në STEM, STEMInists, organizuar

nën përkujdesjen e kryeministrit, ku janë krijuar edhe kushtet për rrjetëzimin e vajzave dhe grave në këto fusha si dhe për mundësitë për punë praktike, mentorim dhe zhvillim profesional.

Ideatorja e STEMGirls, Erblina Bunjaku, e cila së fundmi është shpallur fituese e çmimit "Harmony Hero Awards" për kategorinë "Nisma Inovative/ Innovative Initiatives", ka njoftuar se gjatë targetimit të ambasadorëve, një nga parimet e organizatës është ta ruajnë barazinë gjinore, të paktën 50 %

vajza dhe gra.

Përveç rrjetit të ambasadorëve, projekti ka aktivitet kryesor ndërtimin e një laboratorit mobil "Shkenca në Lëvizje/Science in Motion", i cili së bashku me ekipin e ekspertëve të fushave STEM dhe një grupi të caktuar të ambasadorëve, STEM do t'i vizitojnë viset rurale të Kosovës rregullisht. Synimi është lidhja e hendekut mes njohurive teorike dhe zbatimit praktik, duke u mundësuar mendjeve të reja të angazhohen me botën e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës.

Ngrihet aktakuzë ndaj një personi për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës (PSK) ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë kundër një të pandehuri me inicialet S. F. për veprën penale krime lufte. I dyshuari, sipas Prokurorisë Speciale, ishte pjesëtar i Sigurimit Shtetëror të Serbisë në kohën kur dyshohet se e kreu krimin në vitin 1998, gjatë luftës së fundit në Kosovë.

PSK-ja ka bërë me dije se ai,

bashkë me dy zyrtarë të tjerë të paidentifikuar, e kishin marrë me forcë në veturën e tyre një mjek me inicialet H. Sh. në vitin 1988 në rrugën Drenas - Prishtinë, e "kishin dërguar në ndërtesën e Sigurimit Shtetëror në Prishtinë, fillimisht u ishte nënshtruar rrahjeve dhe torturave dhe nga ajo ditë për fatin e tij nuk dihet asgjë".

Me këto veprime i pandehuri, në bashkëkryerje,

ka kryer veprën penale "krime lufte kundër popullatës civile" nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të RSFJ-së, njoftoi Prokuroria.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.



BE-ja mohon se propozimi i Kurtit ishte i vetmi në tavolinë

BRUKSEL, 15 SHTATOR - Bashkimi Evropian i ka hedhur poshtë pohimet e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se gjatë takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel, vetëm ai ka paraqitur një propozim të sekuencuar për zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e raporteve mes dy vendeve, duke theksuar se BE-ja ka paraqitur para palëve një plan të saj për implementimin e sekuencuar.

Të enjten është mbajtur raundi i radhës i bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili ka përfunduar pa ndonjë pajtim mes palëve.

Duke rikujtuar se përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Josep Borrell, ka

thënë se BE-ja e ka dorëzuar propozimin e kompromisit që implementimi të shkojë paralelisht, burimet e BE-së i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se qysh në qershor i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, kishte paraqitur një plan të sekuencuar dhe për të kishte pasur deri më tash shtatë raunde të takimeve të ndara me palët. Prandaj, ai ka thënë këto burime, pohimi i kryeministrit Kurti se propozimi i tij ka qenë i vetmi në tavolinë, është "thjesht i pasaktë".

Dokumenti, në të cilin thirren burimet e BE-së, përmend që zbatimi do të niste me "hapjen e procesit negociues për statutin e instrumenteve për vetëmenaxhim të serbëve në Kosovë", që

nënkupton Asociacionin e Komunave.

Paralelisht, Serbia nuk do të insistonte më në përdorimin e asteriskut dhe fusnotës, apo pjesëmarrjen e UNMIK-ut në forumet rajonale. Pastaj do të përmbylleshin negociatat për "statutin e instrumenteve të vetëmenaxhimit për serbët e Kosovës".

Hap i radhës, sipas këtij propozimi të BE-së, do të ishte që palët të mos ndërhyjnë në punët e brendshme të njëra-tjetrës dhe do të përmbaheshin nga çdo formë e dhunës, apo nxitjes së dhunës. Sipas BE-së, më pas do të vendoseshin "instrumentet e vetëmenaxhimit për serbët e Kosovës" dhe paralelisht do të ndërpriteshin strukturat e

administruara nga Serbia në Kosovë dhe transformimi i tyre nën instrumentet e vetëmenaxhimit. Kjo do të pasohej nga njohja e dokumenteve dhe simboleve shtetërore. Si hap i radhës do të ishte marrëveshja për një udhërrëfyes të obligueshëm për zbatimin e obligimeve që dalin nga marrëveshjet nga e kaluara në dialog. "Formalizimi i statutit të Kishës Ortodokse të Serbisë në Kosovë" do ta përbënte hapin e radhës, pasuar nga aranzhimet praktike për shkëmbimin e misioneve të përhershme. Serbia, pas kësaj, nuk do ta kundërshtonte anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare, ndërsa Kosova do ta kompletonte procedurën e brendshme për mbrojtjen e objekteve kulturore

dhe fetare serbe.

Po ashtu, sipas propozimit të BE-së, do të vendosej një grup i veçantë i punës, i udhëhequr nga Bashkimi Evropian, për implementimin e neneve të marrëveshjes. Kurse pas kësaj do të pasonte organizimi i konferencës së donatorëve dhe përgatitja e projekteve nga palët. Në fund, sipas këtij propozimi të BE-së, do të nisnin negociatat për marrëveshjen ligjërisht obliguese për normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve.

Ky dokument në të cilin thirren burimet e BE-së mban datën e 19 korrikut të këtij viti.

Takimi i së enjtes mes kryeministrit Kurti dhe presidentit Vuçiq u mbajt me ndërmjetësimin e shefit të politikës së jashtme të BE-së, Borrell, dhe të dërguarit të BE-së për dialogun, Lajçak. Takimi, që kishte në agjendë zbatimin e Marrëveshjes Bazë për Normalizimin e Marrëdhënieve, nuk prodhoi ndonjë rezultat, tha Borrelli.

Sipas tij, ishte Kurti ai që nuk e pranoi propozimin e BE-së për zbatimin e njëkohshëm të obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje, ndërsa Vuçiqi e pranoi.

Borrelli ka thënë se Kurti këmbënguli që të formalizohet, fillimisht, njohja de facto e Kosovës nga Serbia, kurse Vuçiqi kërkoi themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Kurti "nuk ka qenë i gatshëm të ecë përpara me fillimin e një procesi të besueshëm për themelimin e Asociacionit", ka thënë Borrelli.

Kurti dhe Vuçiqi, në konferenca të ndara për medie, e akuzuan njëri-tjetrin për mungesë të rezultateve nga takimi. Kurti tha se "kushtëzimi i Serbisë" për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe "është shndërruar në qëndrim të emisarëve të BE-së". Sipas Vuçiqit, Kurti, thjesht, "i shmanget formimit të Asociacionit. Ky është thelbi i gjithçkaje".



ShBA-ja dhe Gjermania, të zhgënjyera për mungesën e përparimit në dialog

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) është shprehur i zhgënjyer për mosarritjen e ndonjë përparimi në raundin e ri të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. "Presim që të dyja vendet t'i marrin seriozisht obligimet e tyre me Marrëveshjen për Normalizimin e Marrëdhënieve që kanë arritur këtë vit. Koha po kalon. Ne duam të shohim përparim në obligimet ekzistuese dhe të mëparshme, të ndërmarra në

dialog dhe me Marrëveshjen e Ohrit, duke përfshirë këtu themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe", ka thënë një zëdhënës i DASH-it për "REL"-in.

Ai ka bërë me dije se do të konsultohen me Bashkimin Evropian për çështjen e dialogut. "Ne do të konsultohemi brenda dhe me partnerët tanë evropianë për hapat e ardhshëm", ka thënë ai. Sipas tij, dialogu i lehtësuar nga BE-ja është e vetmja rrugë përpara për Kosovën dhe Serbinë. Ndërsa zëdhënësi i Qeverisë Federale të Gjermanisë,



Steffen Hebestreit, ka thënë se është shumë zhgënjyese që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë përsëri ka qenë i pasuksesshëm. Hebestreit ka thënë se pengesat nuk do të

krijonë rrugë për dalje nga kriza dhe ka përsëritur se dialogu për normalizim që drejtohet nga BE-ja është e vetmja rrugë për të shkuar te zgjidhja.

Zëdhënësi i qeverisë së kancelarit Olaf Scholz ka thënë se Gjermania do të vazhdojë të punojë në mënyrë intensive me partnerët e saj për këtë gjë. "Shumë zhgënjyese që takimi i dialogu në mes të Serbisë dhe Kosovës ishte sërish i pasuksesshëm. Pengimi nuk do të na nxjerrë nga kriza. Dialogu i normalizimit, i udhëhequr nga BE-ja, është mënyra e vetme për një zgjidhje. Gjermania do të vazhdojë të punojë intensivisht me partnerët e saj për këtë", ka thënë Hebestreit.

Qytetarët e Kosovës për një vit shpenzuan mbi 4 milionë euro për vizat Shengen

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Mbi katër milionë euro kanë shpenzuar qytetarët e Kosovës vitin e kaluar për tarifat e vizave në shtetet e zonës Shengen. Statistikat e Shengenit tregojnë se 121 97 aplikime për viza janë paraqitur nga shtetasit e Kosovës në vitin 2022, raporton "Schengen VisaInfo.com". Liberalizimi i vizave në vitin 2024 jo vetëm që do t'i hapë kosovarët ndaj botës, por edhe do t'u kursejë shumë para, pasi nuk do të shpenzohen shuma parash për tarifat e vizave të cilat kushtojnë rreth 35 euro vetëm për aplikim. Shpenzimet janë edhe më të larta pasi në qendrat e aplikimit për viza qytetarët paguajnë edhe më shumë për shërbimet e tjera të përfshira gjatë procesit të aplikimit, që ndonjëherë kjo shumë mund

të sillet prej 150 deri në 200 euro, raporton SchengenVisaInfo.com. Statistikat e Shengenit tregojnë se 121 97 aplikime për viza janë paraqitur nga shtetasit e Kosovës në vitin 2022, që tregon se 4.2 milionë euro janë shpenzuar për tarifat e vizave në shtetet e zonës Shengen. 13 674 aplikacione janë refuzuar vitin e kaluar, që kushtuan mbi 478 mijë euro. Gjatë vitit 2022 aplikimet për viza që u dorëzuan nga shtetas kosovarë shënuan një nivel rekord, dhe këto shifra mund të rriten edhe më shumë pasi që gjithnjë e më shumë kosovarë po aplikojnë për viza për të udhëtuar drejt zonës së Shengenit. Në nëntë vitet e fundit kosovarët kanë shpenzuar përafërsisht 22.3 milionë euro për aplikime për viza, ku shpenzimet më të larta janë regjistruar në



periudhën pas dhe para pandemisë, konkretisht gjatë vitit 2022 dhe 2019, përkatësisht me 108 774 aplikime për viza të paraqitura në vitin 2019. Rritja e numrit të kërkesave për viza të paraqitura në kohën e pandemisë ishte 24

566 mijë (2020) përkatësisht 44 666 mijë (2021) aplikime të paraqitura. Për më tepër, numri mesatar i aplikacioneve të paraqitura nga viti 2014 deri në vitin 2022 është 71 860, që arrin deri në 2.5 milionë euro. Megjithatë, shpenzimet do

të konsideroheshin edhe më të larta në kohën para pandemisë, pavarësisht faktit se u depozituan më pak aplikime, shkalla e refuzimit ishte dukshëm më e lartë se pas vitit 2020. Më konkretisht, shkalla e refuzimit në vitin 2014 ishte 24 për qind, me 17 831 kërkesa për viza të refuzuara. Në vitin 2015 shkalla e refuzimit ishte 19.6 për qind, ndërsa ato ranë pak në periudhën pas pandemisë pasi vetëm 11.2 për qind e aplikimeve u refuzuan. Vitin e kaluar 102 017 aplikime për viza kanë rezultuar të suksesshme, duke iu mundësuar aplikantëve nga Kosova ta vizitojnë zonën Shengen, ndërsa numri i përgjithshëm i vizave me shumë hyrje që u lëshuan gjatë vitit të kaluar ishte 4 360.

Termocentrali austriak testoi kombinimin e gazit natyror dhe hidrogjenit për prodhimin e energjisë elektrike

VJENË, 15 SHTATOR - Kombinimi i gazit natyror dhe hidrogjenit për prodhimin e energjisë elektrike u testua për herë të parë në termocentralin e gazit Donaustadt në Vjenë, me një përmbajtje hidrogjeni prej 15-përqindësh. Ky është testi i parë i këtij lloji në botë, njoftuan autoritetet e Vjenës. Në testimin me vlerë dhjetë milionë euro, përveç kompanisë vjeneze energjetike "Wien Energie" dhe asaj austriake "Verbund", marrin pjesë edhe kompanitë gjermane "RheinEnergie" dhe "Siemens Energy". Siç kanë vlerësuar ata, testimi është i një rëndësie evropiane dhe globale, sepse më shumë se pesë turbina Siemens Energy CCGT, të cilat përdoren në Vjenë, janë në funksionim në Evropë dhe më shumë se 360 në mbarë botën. Me përfundimin dhe vlerësimin me sukses të provës, turbina, siç presin, mund ta marrë certifikimin e



nevojshëm që në vitin e ardhshëm dhe më pas planifikohet të rritet përqindja e hidrogjenit 30 për qind. Për përzierjen e përditshme të hidrogjenit është e nevojshme, siç arsyetuan ata, të rritet kapaciteti prodhues i

hidrogjenit të gjelbër, domethënë atij që krijohet nga burimet e rinovueshme të energjisë. Ekspertët presin që prodhimi global i hidrogjenit të rritet gjatë dekadës së ardhshme dhe deri atëherë sasi të mjaftueshme të hidrogjenit të

gjelbër do të jenë të disponueshme për përdorim në termocentrale dhe impiante industriale. Autoritetet e Vjenës filluan këtë vit ndërtimin e fabrikës së parë të elektrolizës në qytet. Siç kanë njoftuar ata, nga vjeshta do të prodhohen deri

në 1 300 kilogramë hidrogjen jeshil në ditë për përdorim në autobusë, për shitje privatëve apo për përzierje në një termocentral. Strategjia urbane e hidrogjenit është një nga hapat e rëndësishëm, siç theksuan ata, në tranzicionin e qytetit me dy milionë banorë drejt neutralitetit të karbonit deri në vitin 2040. Për shembull, shtimi i 15 për qind të hidrogjenit të gjelbër do të kursente 33 mijë ton dyoksid karboni (CO2) për vit. Termocentrali Donaustadt i Vjenës, ku po bëhet testimi, prodhon 350 megavate nxehtësi dhe deri në 395 megavate energji elektrike. Në punën e kombinuar, ai arrin një efikasitet prej më shumë se 86-përqindësh. Në vitin 2020 termocentrali prodhoi energji elektrike ekuivalente me konsumin e 850 mijë familjeve dhe ngrohje për më shumë se 150 mijë familje, thanë autoritetet e Vjenës.

Lirohet ish-kryeshefi i KEK-ut, Nagip Krasniqi

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Është liruar nga paraburgimi ish-kryeshefi i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Nagip Krasniqi. Kërkesa për lirim nga paraburgimi për Krasniqin është bërë nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe është aprovuar nga gjyka-

ta. Masa e paraburgimit është zëvendësuar me masën e ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar. Krasniqi nuk do të mund t'i afrohet më shumë se 50 metra objektit të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe personave që janë të punë-

suar në KEK. Krasniqi ishte arrestuar më 19 prill nën dyshimet për tri vepra penale, të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, ushtrimit të ndikimit dhe konfliktit të interesit. Rasti përfshin dy kontrata njëburi-more në vlerë 3.5 milionë euro.



Klima, sa të shqetësuar duhet të jemi?



Ashtu si shumë aspekte të jetës moderne, reagimi ynë ndaj ndryshimeve klimatike duket se po polarizohet gjithnjë e më shumë. Nga njëra anë, ka njerëz që thonë se temperaturat në rritje tregojnë se bota siç e njohim ka vetëm disa dekada e pastaj vjen fundi dhe nuk mund të bëjmë asgjë për ta parandaluar këtë. Nga ana tjetër, kemi nga ata që pretendojnë se vetë nocioni i ndryshimit klimatik të krijuar nga njeriu është një komplot ndërkombëtar.

Asnjë nga këto pozicione ekstreme nuk qëndron. Ndryshimet klimatike të shkaktuara nga njerëzit nuk janë një teori konspirative, por është po aq e vërtetë se katastrofa globale nuk është një përfundim i paramenduar.

E sigurt është se nivelet në rritje të gazeve serrë në atmosferën tonë po rrisin temperaturat në mbarë botën dhe ky proces do të vazhdojë derisa të ndalojmë emetimin e më shumë prej tyre. Me fjalë të tjera, ndryshimi i klimës po ndodh dhe ne mund ta ndalojmë atë nëse vendosim. Ajo që është e pasigurt, është se çfarë do të bëjmë në të vërtetë për ta luftuar atë.

Pra, kemi siguri dhe pasiguri – “të njohurat e njohura” dhe “të panjohurat e njohura”, siç

thoshte ish-sekretari amerikan i mbrojtjes, Donald Rumsfeld. Fatkeqësisht, njerëzit, si në nivel individual ashtu edhe në atë shoqëror, nuk mundin të përballen me një kombinim të tillë.

Marrim së pari të njohurat e njohura. Duke lënë mënjanë mohuesit, shumica e njerëzve janë të vetëdijshëm se ndryshimet klimatike po ndodhin dhe ne duhet të bëjmë diçka për këtë. Problemi është se kjo e njohur është aq e njohur sa që është bërë pjesë e sfondit të përditshmërisë. Shumë pak prej nesh janë në gjendje të kalojnë një sasi proporcionale të kohës duke u merakosur për ndryshimet klimatike, duke pasur parasysh gjithçka tjetër që bota na kërkon t'i kushtojmë vëmendje – qofshin ato punët tona, familjet, inflacioni në rritje, varfëria apo edhe lufta.

“Psikologjikisht, ne jemi krejtësisht të papërshtatshëm për të përballuar probleme afatgjata, që janë në rritje të vazhdueshme”, thotë Katherine Hayhoe në Universitetin Teknik të Teksasit. Dhe për shkak se ndjenjat publike ndryshojnë, po ashtu ndryshon edhe vullneti politik për të trajtuar këtë çështje: për momentin, shumë pak qeveri janë të gatshme të kenë biseda të

sinqerta me votuesit rreth kostove, rreziqeve dhe përfitimeve të trajtimit të ndryshimeve klimatike, përtej premtimeve gjeneraliste për të arritur emetimet zero, pa specifikuar faktikisht se si.

Aktivistët e klimës, duke përfshirë Greta Thunberg dhe lëvizjen Just Stop Oil në Mbretërinë e Bashkuar, kanë përdorur forma të ndryshme proteste në një përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike, mbi zhurmën e sfondit të jetës së përditshme. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të tyre, një sondazh i fundit i YouGov me të rritur në Mbretërinë e Bashkuar zbuloi se ata mendonin se mjedisi ishte vetëm çështja e katërt më e rëndësishme me të cilën përballet vendi, pas ekonomisë, shëndetit dhe emigracionit. Ironikisht, të gjitha këto çështje do të preken masivisht nga ngrohja e botës, e cila do të dëmtojë produktivitetin, do të shkaktojë vdekje të hershme dhe do të rrisë migrimin ndërsa njerëzit kërkojnë të largohen nga pjesët e botës që po bëhen gjithnjë e më të pajetueshme.

Ngjarjet ekstreme, siç sapo kemi përjetuar në korrik me muajin më të nxehtë të regjistruar, përqendrojnë vëmendjen më

shumë se parashikimet distopike të së ardhmes, por edhe atëherë reagimet mund të jenë të përziera. Për shembull, temperaturat rekord në Death Valley, Kaliforni, janë kthyer në një atraksion turistik.

Një mënyrë për të sqaruar lidhjen midis ngjarjeve të tilla dhe prirjes afatgjatë të klimës është shkencën në rritje e studimeve të atributimit të klimës. Ndërsa dikur mund të na është dashur të flasim në përgjithësi, duke thënë se disa lloje ngjarjesh do të bëhen më të mundshme nga ndryshimet klimatike, tani mund të jemi specifikë. Sipas iniciativës World Weather Attribution, valët e të nxehtësisë në SHBA dhe Evropë këtë korrik do të kishin qenë “praktikisht të pamundura” në një botë pa ndryshime klimatike të shkaktuara nga njerëzit.

Le të kthehemi tani tek të panjohurat e njohura. Për njerëzit tashmë të përfshirë me rreziqet e ndryshimeve klimatike, këto janë shqetësimet më të mëdha. A duhet të kishim parashikuar motin ekstrem të korrikut? A është ngrohja globale më e keqe nga sa prisnim? Si do të përshtatemi me nxehtësinë ekstreme? A mund të përjetojmë “pika kthese” në një kaskadë që rezulton në ngrohje të trufeshme? Këto janë të gjitha pyetjet të

vlefshme.

Por të përqendrohesh në to deri në masën e veprimit paralizues, siç bëjnë disa që parashikojnë fundin e botës, është njësoj si të lejosh që frika e një aksidenti vdekjeprurës me makinë të të pengojë të lëvizësh timonin për ta shmangur atë.

Pastaj janë të panjohurat që lidhen me veprimet tona. A mund të dekarbonizojmë aq shpejt sa për të shmangur skenarët më të këqinj? A do të jemi në gjendje të bëjmë që teknologjitë e paprovuara si kapja dhe ruajtja e karbonit të funksionojnë? Këto janë më të vështira për t'u përgjigjur dhe kërkojnë shumë më tepër shikim të topit të kristaltë, por lajmi i mirë është se kalimi të burimet e rinovueshme po ndodh më shpejt sesa mund ta kuptojmë, me veprime të forta si nga SHBA ashtu edhe nga Kina.

Në fakt, mund të jemi vetëm disa vjet larg nga fillimi i fundit për lëndët djegëse fosile.

Së fundi, është e panjohura në zemër të gjithë ankthit tonë lidhur me klimën: sa të shqetësuar duhet të jemi? Ajo që mund të bëjmë, është të kemi gjithmonë një vlerësim të qartë dhe të matur të shkencës. Asnjë fund bote. Asnjë mohim. Thjesht realitet. / new scientist – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Përplasen FFK-ja dhe FC Prishtina

Ndeshja e fundjavës në Superligë në mes të FC Prishtina dhe FC Liria është bërë “sebe” për përplasjen në mes të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe skuadrës kryeqytetase lidhur me vendin e zhvillimit të kësaj ndeshjeje

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe FC Prishtina janë përplasur të premten lidhur me vendin se ku do të zhvillohet ndeshja e fundjavës në mes të Prishtinës dhe Lirisë. Ka qenë fillimisht klubi kryeqytetas që ka njoftuar se do të rikthehet në stadiumin “Fadil Vokri” për t’i zhvilluar ndeshjet kampionate. FC Prishtina në njoftimin e bërë në faqen zyrtare kishte paralajmëruar se ndeshja me rivalen e vjetër Lirinë zhvillohet

të dielën nga ora 15:00. “I kemi njoftuar me kohë sipas propozicioneve të garave, FFK-në, Policinë e Kosovës dhe të gjithë aktorët e tjerë që marrin pjesë në organizimin e ndeshjeve kampionale, se ndeshja zhvillohet sipas orarit në fushën tonë në stadiumin ‘Fadil Vokri’. Po ashtu, kemi shtypur biletat dhe iu kemi përgjigjur kërkesës së skuadrës mysafire për praninë e tifozëve të saj. Prishtina rikthehet në fushën e saj pas mirëkuptimit që fusha të ruhej për ndeshjet e Kosovës”, thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Klubi kryeqytetas ka ftuar tifozët



të jenë në numër sa më të madh në përkrahje të klubit të zemrës. Çmimi i biletave është 3 euro në tribunën perëndimore, 2 euro në tribunën lindore dhe 1 euro në tribunën veriore, ndërsa tribuna jugore është e rezervuar për adhuruesit e Klubit “Plisat”. Ndërkohë ka edhe reagimi i Federatës së Futbollit të Kosovës. Shtëpia e futbollit e Kosovës e ka demantuar skuadrën e

Prishtinës në lidhje me njoftimin se ndeshja e fundjavës Prishtina - Liria do të zhvillohet në stadiumin “Fadil Vokri”. FFK-ja ka bërë me dije se kjo ndeshje do të zhvillohet në Hajvali. “Komisioni i Garave i Superligës dhe Ligës së Parë me kohë ka njoftuar FC Prishtina se ndeshja e javës së 5-të në Albi Mall Superligë, ndërmjet FC Prishtina dhe FC Liria, nuk do të mund të

zhvillohet në stadiumin ‘Fadil Vokri’, ngaqë menjëherë pas përfundimit të ndeshjeve të ekipeve kombëtare, FFK ka filluar procesin e riparimit të fushës”, thuhet në njoftimin e FFK-së.

Më pas në njoftimin e Federatës së Futbollit thuhet se FFK-ja i ka dalë në ndihmë FC Prishtina, duke ia vënë në dispozicion stadiumin me bari natyral në Kampin Nacional të FFK-së për zhvillimin e kësaj ndeshjeje, ashtu siç ka bërë edhe në ndeshjet e kaluara të këtij edicioni. “Komisioni i Garave ka vendosur që ndeshja në fjalë të zhvillohet më 17 shtator në orën 15:0, në Kampin Nacional në Hajvali. Pas kësaj jave, sipas ekspertëve të fushës, përfundon faza e rikuperimit të fushës dhe do të mund të rifillojë zhvillimi i ndeshjeve të Superligës në stadiumin ‘Fadil Vokri’”, thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit.

Aliti për ‘Blick’: Kosova është shtet i pavarur

CYRIH, 15 SHTATOR - Ndeshja në mes të Rumanisë dhe Kosovës, e luajtur për kualifikueset e “Euro 2024” dhe që përfundoi me shifrat 2-0 për vendësit, u ndërpre për më shumë se 50 minuta në pjesën e parë. Arsyja ishin huliganët rumunë që shpalosën një banderolë në të cilën shkruhej “Kosova është Serbi”. Në lidhje me këtë ngjarje reagoi edhe mbrojtësi i Kosovës, Fidan Aliti. Mbrojtësi që aktualisht është pjesë e Alanyasporit në Turqi theksoi në një intervistë për zvicëranen “Blick.ch” se Kosova është një vend i lirë.



“Blick”: Aliti, fillimisht barazimi 2-2 ndaj Zvicrës në Prishtinë, pastaj humbja 2-0 me skandalin në Rumanë. Sa emocionues ishte ky takim mes Kosovës dhe Zvicrës?
Aliti: Ndeshja ndaj Zvicrës ishte shumë emocionuese. Përgjigja më e mirë ndaj ngjarjeve të patolerushme në Rumanë do të ishte qenë që ne të fitonim. Fatkeqësisht nuk ia dolëm.

“Blick”: Loja u ndërpre për gati një orë sepse ju dhe kolegët tuaj u ofenduat nga tribuna dhe në sektorin e tifozëve rumunë u ngrit një pankartë që thoshte “Kosova është Serbi”.
Aliti: Këto janë deklarata politike që nuk kanë vend në futboll. Racizëm i hapur. Kosova është shtet i pavarur.

“Blick”: A mund të kishit qëndruar në dhomat e zhveshjes dhe ta braktisnit ndeshjen?
Aliti: Nëse e shohim tani në të ftohtë, ky do të ishte vendimi i duhur. Vetëm atëherë do të kishim bërë një deklaratë të vërtetë. Në fund loja përfundoi normalisht dhe

askush nuk u penalizua.

“Blick”: Çfarë po diskutoni në dhomat e zhveshjes gjatë ndërprerjes?
Aliti: Fillimisht zhvilluam një diskutim taktik. Deri atëherë ishim më mirë se Rumania dhe e kishim lojën nën kontroll. Më pas një delegacion i UEFA-s hyri në dhomën e zhveshjes dhe patëm një diskutim të gjatë.

“Blick”: Ndeshja vazhdoi dhe Kosova nuk luajti siç e nisi. Pse?
Aliti: Ju ftoj të pyesni gjyqtarin për këtë. Kjo ishte fatkeqësi! Pas rifillimit, ai vazhdimisht fishkëlleu gjithçka kundër nesh. Kartoni i kuq ishte qesharak dhe u shpik një penallti për Rumaninë. Ky nuk është një justifikim, mund ta shikoni lojën përsëri, mos ngurroni.

“Blick”: Edhe himni juaj u vërshtëllje. Sa dhemb kjo?
Aliti: Ne i prisnim dhe si profesionistë duhet të jemi në gjendje t’i përballojmë ato. Por

njerëzit vazhduan të bërtisnin “Kosova është Serbi” dhe askush nuk u përgjigj. Vetëm me pankartën u duk se ishte kaluar përfundimisht kufiri.

“Blick”: Kjo armiqësi erdhi vetëm tre ditë pas “miqësore” kundër Zvicrës në Prishtinë...
Aliti: Për ne lojtarët, ndeshja me Zvicrën nuk ishte miqësore. Ne donim të fitonim, kishte shumë në lojë. Më beso; në një duel harron se kush është shoku yt. Por, për të gjithë njerëzit në Prishtinë loja ishte padyshim një festë e madhe. Fakti që shënuam për 2-2 në fund ishte e merituar.

“Blick”: Gjashtë ndeshje, katër pikë. E keni humbur tashmë pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian?
Aliti: Këto pikë mund të mos mjaftojnë më. Por, kampionatin evropian nuk e humbëm kundër Zvicrës dhe Rumanisë, por më parë me barazimin ndaj Andorrës dhe humbjen ndaj Bjellorusisë.

Këto mund të jenë dënimet e UEFA-s për Rumaninë

PRISHTINË, 15 SHTATOR - UEFA të enjten nisi hetimet ndaj Federatës së Futbollit të Rumanisë, e cila ngarkohet me gjashtë pika për thyerjen e rregullave në ndeshjen me plot skandale kundër Kosovës. Tifozët rumunë bënë provokime nacionaliste ndaj ‘Dardanëve’, duke e

shpalosur një pankartë me mbishkrimin ‘Kosova është Serbi’, ndërsa brohoritën edhe ‘Serbia, Serbia’, me ç’rast u ndërpre loja për gati një orë, për të vazhduar më pas dhe për të fituar rumunët me rezultat 2-0. Por, kjo nuk është arsyeja e vetme për të cilën mund të dënohen rumunët, pasi ata

përfunduan në procedurë disiplinore edhe për pesë raste të tjera që lidhen me bllokimin e rrugëve, ndezjen e objekteve piroteknike, hedhjen e gjësëndeve në fushë, mesazhet ofenduese provokuese dhe sjelljet raciste. Në bazë të rregullave të shtëpisë së

futbollit evropian, Kombëtarja e Rumanisë mund të dënohet me dy ndeshje pa praninë e shikuesve kundër Andorrës më 15 tetor dhe ndaj Zvicrës më 21 nëntor. Gjithashtu, Federata Rumune e Futbollit mund të gjobitet 100 mijë euro. Rumunët ishin gjobitur më parë nga



UEFA 15 mijë euro në këto eliminatorë pas këndimeve dhe thirrjeve të tifozëve në ndeshjen me Bjellorusinë.

Ibrahimoviq paraqitet te Frosinone: Modeli im është Goretzka

FROSINONE, 15 SHTATOR - Një tjetër përforsim nga Bayern Muncheni për Frosinonen që ka siguruar një tjetër shqiptar nga kampionët e Gjermanisë pas Marvin Çunit. Skuadra e rikthyer në Serinë A

është përforsuar në ofensivë me shërbimet e Arijon Ibrahimoviqit, i cili u huazua nga "bavarezët". "Modeli im është Leon Goretzka. Ai më ka dhënë shumë këshilla. Më pëlqen të luaj si numër 8 ose 10,

por më parë kam luajtur edhe si sulmues krahu dhe qendërsulmues", ka thënë Ibrahimoviqi. "Frosinone? Ndoshem këtu prej pak kohësh, por e kam kuptuar menjëherë se skuadra dhe tifozët

janë si një familje. Mezi pres të luaj dhe ta shoh stadiumin plot. Forma ime është e mirë. Nuk e di nëse jam në gjendje të luaj 90 minuta, por jam gati të zbres në fushë nga minuta e parë", ka shtuar Ibrahimoviqi.



Rashica: Klubi ku doja të luaja ishte Beshiktasi, uroj ta fitojmë titullin

STAMBOLL, 15 SHTATOR - Futbollisti i Kosovës, Milot Rashica, ka folur edhe një herë për zgjedhjen e tij për t'u transferuar te Beshiktashi, për të cilin klub ka thënë se donte dhe mezi pres të luajë përsëri para tifozëve të zhurmshtëm. "Sezonin e kaluar pata një sezon të mirë dhe kalova shumë mirë me të gjithë atje. Kam bërë më të mirën, kam fituar një kampionat në fund të sezonit, por kam qenë një futbollist i huazuar. Kontrata ime kishte skaduar", ka thënë fillimisht Rashica. "Unë jam futbollist profesionist, kjo është puna dhe karriera ime. Gjithmonë duhet të mendoj për hapin tjetër. Ndër ofertat që kam marrë, klubi që më donte më shumë dhe ku doja më shumë të luaja ishte Beshiktashi. Ne mbajmë takimet tona dhe arrijmë një marrëveshje", ka shtuar Rashica. "Mbi të gjitha uroj që ekipi ynë të ketë një sezon të mbarë dhe ta kurorëzojë sezonin me kupën e kampionatit në fund të kësaj rruge. Gjërat mund të mos shkojnë gjithmonë mirë, por vërshtëllima e fundit është në fushë. Unë kam një mentalitet futbollit që nuk ndalon së luftuari derisa të bjerë vërshtëllima e fundit, dhe kjo është arsyeja pse ekipi ynë dhe tifozët tanë mund të jenë të sigurt se sido që të jetë situata aktuale, do të shikojnë një Rashicë që nuk dorëzohet dhe nuk



ndalet së luftuari deri në vërshtëllimën e fundit", ka deklaruar futbollisti "dardan". "Nuk kam pasur probleme të mëdha adaptimi dhe mënyra se si njerëzit më priten ishte shumë e këndshme. Që në momentin e parë që erdha, gjithçka ishte në rregull. Objektet tona, kushtet tona, stadiumi, tifozët tanë... Gjithçka është shumë mirë dhe jam shumë i lumtur që jam në Beshiktash. Është një ndjenjë e mrekullueshme për mua që mund të luaj me fanellën e Beshiktashit".

Në fund, Rashica ka folur për atmosferën të cilën e krijojnë tifozët e klubit bardhezi. "Mendoj se ky detaj është shumë i rëndësishëm sepse ndeshja mund të mos shkojë gjithmonë ashtu siç dëshirojmë, por ju duhet ta mbështetni ekipin tuaj sa më shumë që mundeni. Unë jam luftëtar. Nuk më pëlqen të

dorëzohem në përgjithësi. Kjo është pse mendoj se do të shkojmë shumë mirë me tifozët tanë. Shpresoj që të bëj që tifozët e Besiktasit të shikojnë futboll po aq mirë sa legjendat e klubit luftarak që përmende. Nga ana tjetër, unë luajta në stadiumin tonë si rival sezonin e kaluar dhe atmosfera ishte e mahnitshme. Kishte një zhurmë aq të madhe sa mund të ishte shurdhuese. Për më tepër, të gjithë i dinë rekordet e decibelit të thyer nga tifozët e Beshiktasit. Prandaj është një ndjenjë e mrekullueshme për mua të luaj në këtë stadium ku kam luajtur më parë me fanellën e skuadrës rivale, tani me fanellën e Beshiktashit. Ne do të luajmë futboll duke e ditur që tifozët e Beshiktashit janë pas nesh me atë zhurmë të madhe dhe është një ndjenjë e mirë", ka thënë ylli i Kosovës.

Rrëfim tmerri nga tenistja franceze: Trajneri më përdhunoi 400 herë për dy vjet

PARIS, 15 SHTATOR - Ish-tenistja franceze Angélique Cauchy (36) zbuloi se ish-trajneri Andrew Geddis (56) e përdhunoi 400 herë për dy vjet. Një trajner francez u dënua me 18 vjet burg për abuzim seksual me katër vajza tenisi. Një nga viktimat e këtij përbindëshi ishte edhe Angélique fatkeqe, e cila ishte vetëm 12 vjeçe kur filloi stërvitjen me Geddis.

Cauchi dëshmoi përpara një komisioni hetimor të ngritur për t'i identifikuar mangësitë brenda federatave sportive dhe organeve drejtuese të sportit. Në rrëfimën e saj tronditës, ish-tenistja zbuloi detajet e tmerrshme të ferrit që përjetoi. Ajo theksoi se Geddis e detyroi të bënte seks kur ishte vetëm 12 vjeçe. Ish-tenisti thotë se e ka bërë të besojë se kjo është një praktikë normale mes një lojtareje dhe një trajnerit, sepse ata kalojnë shumë kohë së bashku. Incidenti i veçantë ndodhi gjatë një kampi 15-ditor në La Baule në Francën perëndimore. "Kam jetuar dy javët



më të këqija të jetës sime. Kam menduar shumë herë për vetëvrasje. Më përdhunonte tri herë në ditë. Natën e parë që më kërkoi të shkoja në dhomën e tij, nuk e bëra, kështu që ai hyri në dhomën time. Ishte më keq. Isha në burg. Nuk munda të dilja dhe më pas u detyrova të qëndroja në vendin ku ndodhi", ka rrëfyer ajo. Couchie kujton saktësisht se sa shkallë ndanin dhomat e tyre. Në deklaratën e saj, ajo i përshkroi ato si 13 hapa terrori. Angelik pretendon se Geddis kishte

mbështetjen e presidentit të klubit, prandaj sillej ashtu pasi i çonte tituj. "Në botën e tenisit dihej se sjellja e tij ndaj vajzave të reja nuk ishte korrekte. Kur një grua u ankua te presidenti i klubit, përgjigja ishte: 'E di, por ai na sjell tituj'".

Në vitin 2021 Monstrum u dënua me 18 vjet burg për përdhunimin dhe sulmin seksual të katër vajzave nga 12 deri në 17 vjeç. Geddis shantazhoi emocionalisht Angélique. I thanë se kishte SIDA, kështu që për pesë vjet vajza fatkeqe ishte e bindur se vuante nga kjo sëmundje e pashërueshme. "Ndërmjet moshës 13 dhe 18 vjeç kam jetuar duke menduar se kisha SIDA", rrëfyer ajo. Kundër dhunuesve dëshmuar edhe viktimat të tjera. Ata theksuan se trajneri i detyroi t'i ndërpresin lidhjet me familjet dhe miqtë e tyre, i përdhunoi në makinën e tij, në dhomat e zhveshjes dhe gjatë kurseve stërvitore.

SHKURT

Dy notarët e Kosovës paraqiten në Lojërat Mesdhetare në Heraklion

Garuesit e notit, Sidrit Desku dhe Arion Budima, kanë garuar në Lojërat Mesdhetare në Rërë Heraklion 2023, disiplina e ujërave të hapura pesë kilometra. Në një konkurrencë tejet të fortë, Desku u rendit në vendin e dhjetë me kohë 1 orë e 4:10.6 sekonda, ndërsa Budima i 11-ti me kohë 1:05:28.0. Për notarët e Kosovës, që janë në moshë të re, Arioni 15 vjeç dhe Sidriti 18, gara e zhvilluar në det është një përvojë e mirë për garat e ardhshme ndërkombëtare. Notarët ishin të fundit nga ekipi i Kosovës që u paraqit në LMR Heraklion 2023.

Veteli mendon rikthimin në garat e Formulës 1

Pasi "mbylli" karrierën në fundin e sezonit 2021-2022, katër herë kampionati i Botës në Formula 1, piloti gjerman Sebastian Vettel, nuk e përjashton një rikthim të mundshëm në botën e garave me makina. Për mediet, Veteli është shprehur se nuk e përjashton një rikthim në garat e Formulës 1, teksa kujtojmë se një veprim të tillë më herët e kanë bërë edhe pilotët e tjerë të shquar, si Fernando Alonso apo Kimi Raikkonen. "Nuk mund të them jo. Mendoj se po t'i pyesje të gjithë pilotët që përfunduan karrierën e tyre, ndoshta disa prej tyre do të kishin thënë jo. Të tjerë thoshin 'nuk e di', por në fund u kthyen të gjithë. Nuk mund ta përjashtoj atë hipotezë", është shprehur Veteli.

Roma i ofron kontratë të re Dybalas

Në Romë tifozët shpresojnë që këtë vit dyshja Dybala - Lukaku të dërgojnë ekipin në një tjetër nivel, ndërsa drejtuesit e klubit po punojnë me kohë të plotë për ta blinduar yllin e ekipit, Paulo Dybala. Sipas "TuttoSport", në javët në vijim është parashikuar një takim ndërmjet drejtuesve të klubit dhe agjentit të Dybalas, Jorge Antun. Palët mund ta gjejnë pajtimin për rinovimin e kontratës deri më 2026, me opsion rinovimi deri më 2027. Roma kërkon ta heqë klauzolën e largimit prej 20 milionë eurosh për ekipet italiane dhe për 12 ekipet jashtë synon të vendosë një klauzolë largimi të përbashkët prej 50 milionë eurosh.

Kimmichi nuk lëviz nga Bayerni

Për Joshua Kimmich u diskutua gjatë në merkaton e verës si opsion për t'u larguar nga Bayern Munchen, aq sa e detyroi vetë protagonistin t'ua jepte fjalën tifozëve "bavarezë" se nuk do të lëvizë nga Munchen, të paktën deri në fund të sezonit aktual. Kontrata me kampionët i skadon në verën e vitit 2025 dhe Barcelona u pa si kërcënimi më serioz. Prestigjiozja spanjolle "Sport" e ka bërë fakt të kryer se Joshua nuk ka asnjë shans për të kaluar te katalanasit, për dy arsye. Së pari, koïncidon me përmirësimin e marrëdhënieve mes Tuchelit dhe Joshuas dhe e dyta përkon me afrimin e Harry Kanes, i cili ka shërbyer si provë se Bayerni i ka të gjitha "kartat" për të fituar gjithçka.

